



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 66/2012
Prishtinë, më 28.05.2012, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku. Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Gani Koci, zëvendësministër në Ministrinë Zhvillimit Ekonomik; Hakif Jashari, Agim Kukaj dhe Arbnor Kastrati-MZHE; Burim Ejupi - INDEP dhe Flamur Hyseni (ekspert ligjor-NDI).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.05.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të privatizimit për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.05.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.05.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të privatizimit për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se në mbledhjen e fundit për mungesë të kuorumit e kemi shtyrë këtë pikë të rendit të ditës dhe kërkoi të votohet Raporti i AKP-së për vitin 2011.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të privatizimit për vitin 2011.

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2011 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP.

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike

Kryetari – E njoftoi Komisionin se kemi pranuar raportin me amendamente nga Komisioni i përhershëm për buxhet dhe financa, ku kanë vërejtje në Amendamentin e 58 të Komisionit kërkohet të fshihet fjala “jobuxhetor” dhe kanë parashtruar tri Amendamente të reja në nenet 79, 81 dhe 83.

Gani Koci (zëvendësministër në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik) – Në emër të Ministrisë kërkoi që Komisioni të këtë parasysh që të ruhet pavarësia e ART-së dhe në përputhje me direktivat e BE-së në lidhje me “të hyrat e dedikuara” dhe “stafin profesional”.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Grupi punues i Komisionit të takohet më Grupin punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për të harmonizuar amendamentet.

5. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit

Kryetari – Theksoi se tani ne kemi Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit të proceduar nga Qeveria dhe kërkoi që të formohet një grup punues për shqyrtim.

Pas debatit Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Në lidhje me formimin e grupit të punës, pas diskutimeve, Komisioni unanimitet nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Hashim Deshishku raportues, Zenun Pajaziti, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka dhe Biserka Kostić- anëtarë;*
3. *Secili anëtar i Komisionit sipas interesimit mund t'i bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
4. *Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimt dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Zenun Pajaziti